

## Zyra Sociale e Dietikon-it

### Informacione për marrëset dhe marrësit e asistencës sociale

#### Bazat juridike

- (Ligji Federal mbi Kompetencën për Përkrahjen e Nevojtarëve)
- ZGB (Kodi Civil i Zvicrës), në veçanti neni 328 dhe 329
- SHG, SHV (Ligji i Cyrihut për Asistencën Sociale dhe rregullorja përkatëse)
- Rregulloret e SKOS-it (Konferenca Svicerane për Asistencën Sociale)

#### Këto parime duhen patur parasysh:

**Marrëset dhe marrësit e formave të ndryshme të asistencës sociale janë të detyruar të ndërmarrin çdo gjë të pranueshme për të përmirësuar situatën e tyre, dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në zgjidhjen e problemeve të tyre.**

1. Personat e **përkrahur** janë të detyruar të informojnë **sipas së vërtetës** organin e këshillimit social mbi rrethanat e tyre financiare (të ardhurat, pasuri, detyrime etj.) dhe të lejojnë shikimin e dokumenteve të tyre.
2. Nuk lejohet që të merren përsipër detyrime të reja financiare pa u konsultuar përpara me organin e këshillimit social.
3. Para organit të këshillimit social duhet të deklarohen **të gjitha të ardhurat** (pagesa ditore të sigurimeve, shpërblime për punën jashtë orarit, shpërblime të veçanta mbi rrogë, trashëgimi, fitime në llotari etj.).
4. Me organin e këshillimit social duhet të konsultohet para se të kryhen **harxhime të jashtëzakonshme** (p.sh. blerje, shpenzime për shkollën e muzikës, riparime të mëdha, pushime, të papritura, dentisti etj.).
5. Për **ndryshimet e rrethanave** duhet të njoftohet organi i këshillimit social mundësisht menjëherë (p.sh. fillimi i punës, ndryshimi i orarit të punës, fillimi i një pune dytësore, ndërrimi i vendit të punës, dhënia me qera e një pjese të banesës etj.).
6. Në **rast të përfitimit të padrejtë të pagesave të asistencës sociale** Zyra Sociale e Dietikon-it ndërmerr sanksione (paralajmërim, shkurtim i pagesave, rimbursim, kallëzim penal).
7. Persona në moshën e punës duhet të paguajnë kontribute në AHV [sigurimet e pleqërisë dhe sigurimet familjare]. Kush nuk punon duhet të paguajë kontributin minimal.
8. **Zyra Sociale** ka të drejtë të **marrë informacione** tek organet e tjera mbi personin e përkrahur ose mbi të afërmit e tij (sidomos mbi faktorët e tatimit në lidhje me përkrahjen eventuale të të afërmeve).
9. **Taksat komunale, taksat e Kantonit dhe ato federale** nuk duhet të paguhen nga pagesat e asistencës. Personat që përkrahen rregullisht, llogaritë tatimore mund t'ia dorëzojnë organit të këshillimit social, që të bëhet një kërkesë për përjashtim.

## **Ekstrakt nga Ligji për Asistencën Sociale (SHG)**

Neni 25 i Ligjit për Asistencën Sociale të Kantonit të Cyrihut të datës 14 qershor 1981 (SHG): Enti social shqyrton se a janë të afërmit të obliguar sipas neneve 328 dhe 329 ZGB për të përkrahur marrësin e asistencës. Në qoftë se kushtet e përligjin këtë, atëherë enti social mund të kërkojë nga personat e obliguar që të japin ndihmë, dhe enti mund të ndërmjetësojë midis të obliguarve dhe marrësit të asistencës.

Neni 26: Personi që ka përfituar ndihmë ekonomike duke parashtruar të dhëna të pavërteta ose jo të plota, është i detyruar për ta kthyer ndihmën.

Neni 27: Ndihma ekonomike e fituar me të drejtë, duhet të kthehet kur kushtet financiare të marrësit të ndihmës ndryshohen pozitivisht për shkak të marrjes së trashëgimisë, fitimit në llo-tari ose për ndonjë arsye tjetër, që nuk bazohet në punën e vet të marrësit, ose kur plotësohen kushtet për kthimin sipas nenit 20 (vlëra pasurore që nuk mund të kthehen në para/pronë e pa-tundshme).

E drejta për të kërkuar kthimin e ndihmave të dhëna mbulon ato pagesa të cilat marrësi i ndihmës i ka marrë për vete, për bashkëshortin gjatë martesës dhe për fëmijët e tij gjatë kohës kur ata ishin të mitur.

Ndihma ekonomike e marrë për vete gjatë miturisë ose deri në përfundimin e një arsimimi të filluar në kohën e miturisë, nuk duhet të kthehet.

Neni 28: Në qoftë se marrësi i ndihmës vdes, atëherë kundrejt trashëgimisë së tij lind e drejta për kthimin e ndihmës ekonomike. Në rast të kërkimit të kthimit duhet të merren parasysh në mënyrë të përshtatshme kushtet e trashëgimtarëve.

Neni 29: Për shumat që kërkohen të kthehen, nuk kërkohen përqindje, përveç në rastin e marrjes së padrejtë të ndihmës.

Neni 30: Nuk mund të kërkohet kthimi i shumave, pagesa e të cilave në momentin e prurjes së urdhëresës së kthimit është bërë para më shumë se 15 vitesh. Nga kjo janë të përjashtuara pagesat, për të cilat është marrë përsipër një detyrim kthimi sipas nenit 20.

E drejta për të kërkuar kthimin parashkruhet pesë vjet pasi enti social ka marrë dijeni për lindjen e kësaj të drejte. Të drejtat e kthimit, për të cilat është vënë peng hipotekor, nuk i nënshtrohen parashkrimit.

## **Ekstrakt nga Rregullorja për Asistencën Sociale (SHV)**

Neni 18: Nëse në personin e kërkuesit të ndihmës ekzistojnë arsye që nuk garantojnë që ai parret e marra në dorë i shfrytëzon sipas qëllimit të dhënë, atëherë pagesat mund të kryhen drejtpërdrejt tek të tretët, ose atij mund t'i jepen bono ose pagesa në natyrë. Mundësisht të menjahohet diskriminimi i kërkuesit të ndihmës.

## **Ekstrakt nga Kodi Civil (ZGB)**

Neni 328 ZGB: Kush jeton në kushte të volitshme, është i detyruar të përkrahë të afërmit e ngushtë të brezave të mëparshëm dhe të mëvonshëm, të cilët pa këtë ndihmë do të binin në skamje. Ngelet i paprekur obligimi i prindërve dhe bashkëshortëve për të mbuluar shpenzimet e jetesës.

Neni 329 ZGB: E drejta për t'u përkrahur duhet kërkuar kundrejt obligimeve sipas rënditjes së të drejtës së tyre të trashëgimit dhe është e kufizuar në atë shumë që është e nevojshme për mbulimin e jetesës së skamnorit dhe që përshtatet me kushtet e të obliguarit. Në qoftë se detyrimi i të obliguarit është i padrejtë për shkak të rrethanave të veçanta, atëherë gjykata mund ta zbusë ose ta heqë obligimin e përkrahjes. Zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat mbi padinë e fëmijës për të kërkuar mbulimin e shpenzimeve të jetesës si dhe dispozitat mbi kalimin e kësaj të drejte të tij komunës.